

Mësimi 3: Puna e Shpëtimit dhe Ekzaltimit

Ju mund ta zhvillonit të gjithë mësimin ose ta ndani atë në segmente më të shkurtra. Përshtateni mësimin me rrethanat tuaja vendore dhe nevojat, moshën dhe kuptueshmërinë e presidencës të kuorunit ose klasës suaj.

PUNA E PRESIDENCËS SË NJË KUORUMI OSE KLASE

Ftojini anëtarët/et e presidencës të lexojnë së bashku te *Manuali i Përgjithshëm: Shërbimi në Kishën e Jezut Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme*, 1.2 (ChurchofJesusChrist.org) dhe ftojini ata/o të kërkojnë punën që Zoti i ka thirrur të përmbushin. Përse është e rëndësishme kjo punë? Çfarë po bëjmë aktualisht që i përmbush këto qëllime? Çfarë synimesh mund të vendosim ose rregullojmë për t'i përmbushur më mirë këto qëllime?

PËRFSHIRJA E ANËTARËVE TË KUORUMIT OSE KLASËS NË PUNË

Kërkojuni anëtarëve të presidencës që t'i shqyrtojnë ato që kanë diskutuar dhe planifikuar si presidencë. (Ju mund të dëshironi t'u kërkonit atyre të shqyrtojnë [rendin e ditës për mbledhjet e presidencës](#) së tyre, përfshirë planet e tyre për shërbim dhe aktivitete.) Pastaj bëni pyetjet e mëposhtme:

- Si jemi tashmë të përqendruar te puna e shpëtimit dhe ekzaltimit?
- Ku mund të përmirësohemi?

Ftojini presidencën të diskutojë se si ata/o mund t'i ndihmojnë anëtarët e kuorunit ose të klasës së tyre që të marrin pjesë më plotësisht në punën e shpëtimit dhe të ekzaltimit. Mund të diskutohen nga presidenca ose nga kuorumi apo klasa pyetje si ato në vijim:

- Si mund ta ndihmojmë njëri-tjetrin që ta jetojë më mirë ungjillin e Jezut Krishtit?
- Çfarë mund të bëjmë për t'u kujdesur për njerëzit në nevojë?
- Si mund t'i ndihmojmë të gjithë që të ndihen të ftuar dhe t'i mirëpresim që të bashkohen me ne?
- Si mund ta nxitim pjesëmarrjen në punën për historinë familjare dhe atë në tempull?

Shihni pyetje të tjera të mundshme në pjesën "Këshillohuni së Bashku" të çdo mësimi tek [Eja, Më Ndiq – Për Kuorumet e Priftërisë Aarone dhe Klasat e Të Rejave](#).

BURIME MBËSHTETËSE

- *Manuali i Përgjithshëm*, kapitulli 1
- Materiali filmik "Youth Responsibility in the Work of Salvation" ["Përgjegjësia e Të Rinjve në Punën e Shpëtimit"]
- Karol F. Mek-Konki, "Jemi Këtu për t'i Shërbyer një Kauze të Drejtë", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2015, f. 12–14
- Efesianëve 4:11–13; Moroni 10:32; Moisiu 1:39